



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA MALËSI E MADHE
KESHILLI



Nr. 1621/3 prot

Koplik më: 03/07/2020

V E N D I M

Nr 38 datë 30 / 06 / 2020

PËR

”Miratimin e kërkesës së Bashkisë Malësi e Madhe së bashku me dokumentacionin tekniko ligjor përkatës, të z. Aleksander Smajlaj, objekti shtëpi banimi e të cilit është dëmtuar nga rënie e zjarrit dhe djegia e plote e banesës, si dhe për akordimin e ndihmës financiare për familjen e këtij shtetasi nga buxheti i bashkisë dhe nga buxheti i vitit 2020 në Ministrinë e Mbrojtjes, programi për “emergjencat civile”

Baza Ligjore

Ligji nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar

Ligji për Prefektin e Qarkut

Ligji Nr. 45/2019 Për mbrojtjen civile,

VKM nr.329 datë 16/5/2012 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore ose fatkeqësitë e tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore”

VKM, Nr.965, datë 02/12/2015 „Për bashkëpunimin ndërinstitucional të strukturave të drejtimit në rastet e emergjencave civile dhe krizave“.

Vendosi;

1. Të miratojë kërkesën e Bashkisë Malësi e Madhe për mbështetje financiare të familjes së shtetasit Aleksander Smajlaj, objekti shtëpi banimi e të cilit është dëmtuar nga rënie e zjarrit dhe djegia e plote e banesës.

2. Të miratojë dokumentacionin tekniko - ligjor përkatës të hartuar nga Bashkia Malësi e Madhe për dëmtimin e shtëpisë.

3. T’i akordojë familjes së shtetasit Aleksander Smajlaj, objekti shtëpi banimi e të cilit është dëmtuar nga rënie e zjarrit, dhënien e ndihmës së menjëherëshme/emergjente financiare në vlerën/shumen 100.000 (njëqind mijë) lekë nga fondi rezervë i buxhetit të Bashkisë Malësi e Madhe i vitit 2020.

4. T’i paraqesë dokumentacionin tekniko-ligjor përkatës të familjes së shtetasit **Aleksander Smajlaj**, objekti shtëpi banimi e të cilit është dëmtuar nga rënie e zjarrit dhe t’i propozojë/kërkojë mbështetje Drejtorisë së Përgjithshme të Emergjencave Civile (DPEC), në Ministrinë e Mbrojtjes për akordimin e pjesës së mbetur të ndihmës financiare, për shkak të pamundësisë së Bashkisë për të mbuluar të gjithë vlerën financiare, për shkak të mungesës së fondeve nga ana e bashkisë.



5. Ndhurma financiare për familjen e shtetasit Aleksander Smajlaj, përcaktohet sipas kriterëve të VKM-së nr.329, datë 16.05.2012.

6. Ndhurma financiare që do të akordohet do të përdoret për t'i ardhur në ndihmë familjes së shtetasit **Aleksander Smajlaj**, objekti shtepi banimi e të cilit është dëmtuar nga rënie e zjarrit.

7. Vlera e dëmeve në orendi, mobilje dhe paisje elektroshtëpiake është 519.300 (peseqind e nentembdhjete mije e treqind) leke. Dëmtime nga ana ndërtimore në vlerën 2.835.763 (dy milion e teteqind e tridhjetë e pese mije e shtateqind e gjashtedhete e tre) leke.

Vlera në total e dëmeve është : 3.355.063 (tre milion e treqind e pesedhjetë e pese mije e gjashtedhjetë e tre) leke.

8. Ky vendim hyn në fuqi sipas nenit 55/6 të ligjit nr.139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore".

9. U miratua më datë 30/06/2020.

10. U shpall me datë 02/07/2020.

SEKRETAR I KESHILLIT

Emirjan Hasmujaj,

KRYETARI I KESHILLIT

Ilir Halaj

